



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Shkurt 2022

Nr: 96

VENDIM

PËR

NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË VULËS SË KZAZ-SË NR. 5, BASHKIA

SHKODËR DHE ZËVENDËSIMIN ME VULË REZERVË

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, e 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në referim të nenit 14, pika 2, shkronja “k”, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, përcaktohet se, sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për administrimin dhe përdorimin e vulës së KZAZ-së dhe njoftimin e menjëhershëm të rasteve të dëmtimit apo të humbjes së vulës së KZAZ-së.

KZAZ nr. 5, bashkia Shkodër, me shkresën nr. 8/1 prot., datë 21.2.2022, informon Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për humbjen e vulës, rrethanat si dhe kërkon pajisjen me vulë rezervë.

Bazuar në informacionin e KZAZ-së nr. 5, nënshkruar nga shtatë anëtarët dhe sekretari në datën 21.2.2022, nga ana e sekretarit të KZAZ nr. 5, u raportua se ka humbur vula gjatë ndryshimit të ZAZ-së. Sapo ka konstatuar humbjen e saj, sekretari ka vënë në dijeni anëtarët e KZAZ-së nr. 5. Gjithashtu, bëhet me dije se një kopje të kësaj shkrese, KZAZ-ja nr. 5 e ka dorëzuar në Rajonin e Policisë.

Në këto kushte, KZAZ nr. 5 kërkon nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së humbur dhe pajisjen me vulë rezervë.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 99, pikat 1, shkronja “b”, e 2, nenin 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të nxjerrë jashtë përdorimit vulën e KZAZ-së nr. 5, bashkia Shkodër, e prodhuar sipas modelit të vendimit nr. 8, datë 24.1.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Të zëvendësojë vulën e KZAZ-së nr. 5, bashkia Shkodër, me vulë rezervë, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022

Formati i Vulës: KZAZ



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. Tekst: Republika e Shqipërisë
4. Tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Numri i Identifikimit: KZAZ- R- 5.
6. Tekst: Zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Shkodër të datës 6 Mars 2022